

VËLLIMI XXVIII /JANAR-MARS/ 2025

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2025**

BULETINI ZYRTAR



**AUTORITETI I
KONKURRENCËS**

PËRMBAJTJA

- Nr.1148, Datë 14.01.2025
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË DAIMLER TRUCK AG DHE AKTIEBOLAGET VOLVO.”
- Nr.1149, Datë 14.01.2025
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË DIAVERUM AB NGA SHOQËRIA M42 LTD”
- Nr.1150, Datë 14.01.2025
“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË M42 LTD, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDË AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË DIAVERUM AB NGA SHOQËRIA M42 LTD”
- Nr.1151, Datë 23.01.2025
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË HBI ACQUISITION CO. S.R.L. NGA SHOQËRIA ORBICO D.O.O.”
- Nr.1152, Datë 23.01.2025
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE TË GRUPIT ASIA PULP & PAPER NGA Z. JACKSON WIJAYA LIMANTARA”
- Nr.1154, Datë 29.01.2025
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË STEFANI & CO SHA NGA SHOQËRIA EUROLAB INTERNACIONAL GRUP SHPK”
- Nr.1155, Datë 29.01.2025
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM INDIREKT NGA SHOQËRIA DR. ING.H.C.F. PORCHE AKTIENGESELLSCHAFT MBI BIZNESIN DHE ASETET QË PËRFSHIJNË BIZNESET *FRANCHISED* TË TREGTIMIT TË MOTORËVE TË DREJTUARA NGA STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD”
- Nr.1156 Datë 29.01.2025
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NDAJ NDËRMARRJEVE VODAFONE ALBANIA SHA DHE ONE ALBANIA SHA NË TREGUN ME PAKICË TË

SHËRBIMEVE CELULARE”

Nr.1157, Datë 05.02.2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SHA NGA SHOQËRIA SIGAL BUSINESS CENTER SHPK.”

Nr.1158, Datë 05.02.2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË SAUBER HOLDING AG DHE FILIALEVE TË SAJ SAUBER MOTORSPORT AG E SAUBER TECHNOLOGIES AG, NGA SHOQËRITË AUDI AKTIENGESELLSCHAFT DHE QATAR HOLDING LLC”

Nr.1159, Datë 13.02.2025

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1130, DATË 07.11.2024 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E SIGURIMIT TË JETËS PËR KREDI”

Nr.1160, Datë 13.02.2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE FUNDWAY L.L.C. DHE TRANSFERIMIN E 40% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË UNLIMITED GAMING SH.P.K. NGA SHOQËRIA FUNDWAY L.L.C. TEK SHOQËRIA BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK.”

Nr.1161, Datë 13.02.2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELTA MED SHPK NGA SHOQËRIA DELTA HOLDING SHPK”

Nr.1162, Datë 07.03.2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË AGNA SHA, SEMAN SUNPOWER SHPK DHE ALBANIAN GENERAL ELECTRICITY SHA”

VENDIM

Nr. 1148, Datë 14. 01. 2025

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË
NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË
DAIMLER TRUCK AG DHE AKTIEBOLAGET VOLVO.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 01. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Investimi”, nënshkruar më datë 25 tetor 2024, palët në marrëveshje janë:

Pala 1: Daimler Truck AG është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë. Objekti i shoqërisë është veprimtaria e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në fushën e zhvillimit,

prodhimit dhe shitjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve, veçanërisht në sektorët e biznesit si: automjetet, veçanërisht automjetet për tregti dhe autobusët, motorët dhe mjetet teknike të të gjitha llojeve; produkte të tjera të inxhinierisë së qarkullimit rrugor; pajisjet, instalimet dhe sistemet elektronike; shërbimet dhe konceptet e lëvizshmërisë dhe transportit etj. Daimler Truck AG zotërohet plotësisht nga Daimler Truck Holding AG.

Daimler Truck AG nuk është i pranishëm në Shqipëri, por gjeneron të ardhura në tregun shqiptar nëpërmjet një distribucioni të pavarur.

Pala 2: Aktiebolaget Volvo është një shoqëri publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Suedisë, aktive globalisht në prodhimin dhe shitjen e kamionëve për rrugë dhe terrene të vështira, autobusëve, pajisjeve të ndërtimit dhe motorëve për det, rrugë dhe terrene të vështira dhe motorëve industrialë.

Aktiebolaget Volvo është shoqëria mëmë e Grupit Volvo, e cila nuk është e pranishme në Shqipëri, por gjeneron të ardhura në tregun shqiptar nëpërmjet distributorëve të saj të autorizuar.

Ndërmarrja e përbashkët (JV) do të krijohet në formën juridike të një korporate aksionare sipas ligjeve të Suedisë. Mund të ketë plotësisht nën zotërim një filial të formës së një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Gjermanisë dhe mundësisht dhe filiale të tjera, [.....]. Fokusi kryesor i JV është zhvillimi i elementeve/ shtresave jodiferencuese të një platforme SDV për automjete tregtare. Kjo përfshin zhvillimin, furnizimin dhe tregtimin nga JV i komponentëve softuerikë dhe harduerikë të Platformës SDV. Ndërsa SDV është qëllimi kryesor i JV, është parashikuar që JV të zhvillojë dhe tregtojë gjithashtu një paketë softuerike për vizionin dhe perceptimin. Vizioni dhe perceptimi është një element i funksionit ADAS¹.

II. Transaksioni

Më datë 25 tetor 2024, shoqëritë Aktiebolaget Volvo dhe Daimler Truck AG kanë nënshkruar “Marrëveshje Investimi”. Gjithashtu ndërmjet palëve, Volvo Business Services International AB (Volvo HoldCo), Aktiebolaget Volvo, Daimler Truck AG dhe Evo Truck SDV AB (Shoqëria), është lidhur një “Projekt - Marrëveshje e Ortakëve”.

Fillimisht JV do të themelohet si një filial i zotëruar plotësisht nga Grupi Volvo. Në datën e implementimit të transaksionit të propozuar, Daimler Truck AG do të blejë 50% të aksioneve të emetuara në JV.

JV do të strukturohet në një mënyrë që të sigurojë kontrollin e përbashkët të Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo, të cilët do të zotërojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi pjesë të barabarta, 50% secila në JV.

JV do të jetë një entitet juridik i veçantë me burime financiare të mjaftueshme për të vepruar në

¹ Konfidenciale

mënyrë të pavarur në një bazë afatgjatë. JV do të tregtojë dhe shesë Platformën SDV si për palët njoftuese, ashtu edhe për palët e treta. Parashikohet që shitjet e JV për palët njoftuese do të kryhen në kushte tregu dhe që JV do të ketë funksionin e saj të shitjeve.

Aktualisht, JV nuk ka plane që të bëhet aktive në Shqipëri në të ardhmen e afërt.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota (JV), nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet (i) tregu për zhvillimin dhe shitjen e platformave të automjeteve të përcaktuara nga softueri (Platforma SDV) dhe (ii) tregu për zhvillimin dhe shitjen e paketave të softuerit për vizionin dhe perceptimin për Sistemet e Avancuara të Ndihmës për Shoferin (ADAS), por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo.

Daimler Truck AG zhvillon, prodhon dhe shpërndan kamionë dhe autobusë dhe ofron shërbime të lidhura për klientët e saj në mbarë botën.

Volvo është aktiv në tregun ndërkombëtar për prodhimin dhe shitjen e kamionëve për rrugë dhe terrene të vështira, autobusëve, pajisjeve të ndërtimit dhe motorëve për det, rrugë dhe terrene të vështira dhe motorëve industrialë.

JV do të jetë aktiv në tregun për zhvillimin dhe shitjen e platformave SDV dhe në tregun për zhvillimin dhe shitjen e grupeve të softuerëve për vizionin dhe perceptimin për ADAS.

Lidhur me tregun për zhvillimin dhe shitjen e grupeve të softuerëve për vizionin dhe perceptimin për ADAS, palët njoftuese deklaron disa aktivitete zhvillimore në lidhje me grupet e softuerëve për vizionin dhe perceptimin për ADAS, por aktualisht nuk e ofrojnë këtë shërbim në treg.

Nga sa më sipër, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe nuk do të sjellë ndryshim apo do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1149, Datë 14. 01. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË DIAVERUM AB NGA SHOQËRIA M42 LTD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 01. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD.

Referuar “Marrëveshje e shitblerjes”, palët në transaksion janë:

Blerësi: M42 LTD është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe, e zotëruar nga Group 42 Holding LTD dhe Mubadala Investment Company P.J.S.C..

Group 42 Holding LTD zotëron X% të aksioneve të shoqërisë M42 LTD dhe ushtron kontroll të vetëm mbi M42 LTD. M42 LTD është një shoqëri globale e kujdesit shëndetësor me fokus teknologjinë, e përqendruar në zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të inteligjencës artificiale dhe informatikës cloud (*cloud computing*) për një gamë të gjerë sektorësh,

Group 42 Holding LTD, [.....].

Shitësi: Diaverum Holding S.à.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Dukatit të Madh të Luksemburgut. Shitësi është një shoqëri portofoli e Bridgepoint, një administrues fondesh me kapital privat.

Target: Diaverum AB është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Suedeze, e cila kontrollohet 100% nga shoqëria Diaverum Holding S.à.r.l.. Target është një ofrues ndërkombëtar i trajtimeve të dializës me rreth 450 klinika të specializuara në 24 shtete nëpër botë, por kryesisht në Evropë.

Shoqëria target, përmes filialeve të zotëruara tërësisht Diaverum International AB, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Suedeze dhe Giallum Handels AB, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Suedeze, zotëron dy filiale të regjistruara në Shqipëri (i) Dia Vita SHPK dhe (ii) NEPHROMED ALBANIA SHPK.

- **Dia Vita SHPK**, si zbatuese e Marrëveshjes së Koncesionit/PPP, “Për shërbimin e hemodializës në spitalet rajonale të Shkodrës, Lezhës, Korçës, Vlorës dhe Elbasanit”, të nënshkruar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, ofron trajtime të hemodializës përmes pesë klinikave.
- **NEPHROMED ALBANIA SHPK**, një shoqëri e specializuar në tregtinë me shumicë dhe pakicë të produkteve dhe pajisjeve mjekësore, duke shërbyer kryesisht për shoqërinë e lidhur të saj Dia Vita SHPK.

II. Transaksioni

Ndërmjet palëve pjesëmarrëse në transaksionin e njoftuar, është lidhur “Marrëveshje e shitblerjes”, në lidhje me Diaverum AB, nënshkruar më datë 11 prill 2023, ndërmjet Diaverum Holding S.à.r.l. dhe GM Healthcare Ltd (M42 LTD).

Referuar kushteve të kësaj Marrëveshje shitësi ka pranuar të shesë dhe blerësi pranon të blejë të gjithë Titujt e shitjes me të gjitha të drejtat bashkëlidhur tyre në Datën e Mbylljes dhe të lirë nga të gjitha barrët.

Pas transaksionit, shoqëria M42 LTD përfiton 100% të aksioneve me të drejtë vote dhe kontrollin e vetëm mbi shoqërinë Diaverum AB.

Ky transaksion është implementuar më datë [.....] dhe aktualisht shoqëria M42 LTD zotëron 100% të drejtave të votës dhe kontrollin e vetëm mbi target.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i përfuturit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit

nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu në të cilin operon shoqëria target, tregu i ofrimit të shërbimeve të dializës.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Trajtimet për dializën realizohen nëpërmjet: (i) Dializa Peritoneale (PD), (ii) Hemodializa (HD) dhe (iii) Terapia e vazhdueshme e zëvendësimit të veshkave (CRRT).

Ky shërbim ka qenë ofruar nga departamenti i Urologjisë pranë Qendrës Spitalore Universitare dhe përfutjesit e këtij shërbimi e merrnin shërbimin pa pagesë si të sëmurë kronik.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 308 datë 21.05.2014 “Mbi miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor” si dhe Vendimit të Këshillit Administrativ të Fondit nr. 88 datë 09.07.2014 “Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të Regjistrat Kombëtar të paketave të financuara nga Fondi”, shërbimi i hemodializës ofrohet nga spitalet publike dhe disa spitale jopublike dhe shpenzimet mbuloheshin nga Fondi.

Pas lidhjes së kontratës së koncesionit dhe bërjes efektive të saj, në qershor 2016, shërbimi i hemodializës ofrohet edhe nga shoqëria “DIA VITA SHPK”, mbajtëse e kontratës së koncesionit, e cila duhet të mbulojë me shërbimin e hemodializës të sëmurët në disa rrethe.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese si dhe një analize të realizuar prej tyre, është konstatuar se shoqëria Dia Vita SHPK zotëron rreth X% në tregun e shërbimit të hemodializës, duke ndjekur Spitalin Amerikan i cili është ofruesi më i madh i këtij shërbimi.

Transaksioni i njoftuar ka për pasojë përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD.

M42 LTD është një shoqëri globale e kujdesit shëndetësor me fokus teknologjinë, [.....].

Transaksioni i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, pasi nuk do të ketë mbivendosje horizontale apo vertikale midis aktiviteteve të M42 LTD dhe Diaverum AB në Shqipëri.

Për sa më sipër, përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe nuk do të sjellë ndryshim apo do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1150, Datë 14. 01. 2025

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË M42 LTD, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË DIAVERUM AB NGA SHOQËRIA M42 LTD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 01. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i sjelljes së shoqërisë M42 LTD, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53, nenet 73 dhe 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD,

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 779 prot., i AK, datë 27.11.2024, “Njoftimi i Përqendrimit ndërmjet M42 Ltd /Diaverum AB”, është njoftuar mbi transaksionin e përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD.

Më datë 11 prill 2023, palët Diaverum Holding S.à.r.l. dhe GM Healthcare Ltd (M42 LTD), kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje e shitblerjes”, në lidhje me shitjen e kuotave të shoqërisë Diaverum AB.

Referuar termave të Marrëveshje, shoqëria M42 LTD ka përfutuar 100% të aksioneve me të drejtë vote dhe kontrollin e vetëm mbi shoqërinë Diaverum AB. Ky transaksion është implementuar më datë [.....].

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese, transaksioni i përfuturit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili u bë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) *ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera*; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Në zbatim të nenit 53, germa b) të ligjit dhe Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, ka patur detyrimin për njoftim shoqëria M42 LTD.

Për mos respektim të afatit të përcaktuar, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë në masën jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve nëse nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij Ligji.

Neni 18 i ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, specifikon se: organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh: a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë; c) rëndësinë e kundërvajtjes; ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar dhe për të vlerësuar rëndësinë/gravitetin e shkeljes, Komisioni i Konkurrencës ka marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Njoftimi është bërë me iniciativën e palës blerëse,
 - Procedura është kryer pasi ka kaluar 6 muaj nga parashikimi i nenit 12, pika 2 e ligjit,
 - Përqendrimi vlerësohet si përqendrim konglomerat, i ndodhur jashtë territorit të Shqipërisë.
- Pala njoftuese është në dijeni të shkeljes dhe ka vlerësuar sa më poshtë:

- Mungesë të efekteve lokale,
[.....] nuk çon në pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës në Shqipëri.

- Transaksion me palë të huaja (foreign to foreign),
Transaksioni është ndërmjet palëve të huaja, duke përfshirë juridiksione të shumta dhe konsiderata të ndërlikuara ligjore. Duke marrë parasysh strukturën dhe madhësinë e grupit Diaverum, filialet në

Shqipëri janë të përfshira në mënyrë indirekte dhe përfaqësojnë vetëm një pjesë shumë të vogël të grupit të target.

- Qasje pro aktive,

Nëpërmjet një qasjeje proaktive për të qenë konform politikave rregullatore, pala njoftuese ka dorëzuar vullnetarisht njoftimin në Shqipëri dhe konfirmon angazhimin e saj për të bashkëpunuar me Autoritetin.

- Angazhimi për pajtueshmëri në të ardhmen

Pala njoftuese ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar politikën e saj të pajtueshmërisë për të shmangur gabime të ngjashme në të ardhmen. Kjo përfshin monitorimin më të afërt të filialeve në të gjitha juridiksionet për të siguruar pajtueshmëri të plotë dhe në kohë me ligjet lokale për kontrollin e përqendrimeve.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD, vendosjen e gjobës mbi:
 - a) shoqërinë M42 LTD, në masën 1,000,000 (një milion) lekë,
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1151, Datë 23. 01. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË HBI ACQUISITION CO. S.R.L. NGA SHOQËRIA ORBICO D.O.O.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23. 01. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë HBI ACQUISITION CO. S.R.L. nga shoqëria ORBICO d.o.o..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë HBI ACQUISITION CO. S.R.L. nga shoqëria ORBICO d.o.o.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë HBI ACQUISITION CO. S.R.L nga shoqëria ORBICO d.o.o..

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, palët në transaksion janë:

Blerësi: ORBICO d.o.o., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt aktiviteti: Blerja dhe shitja e mallrave, kryerja e ndërmjetësimit tregtar në tregun e brendshëm dhe të huaj, përfaqësimi i kompanive të huaja, transporti rrugor i

mallrave, transporti i mallrave në trafikun ndërkombëtar, reklamim, tregtia me shumicë e produkteve mjekësore, prodhimi i produkteve të kremrave, prodhimi dhe shpërndarja e gazit, biznesi i pasurive të paluajtshme, etj.

Shoqëria Orbico, zotëron 100% shoqërinë Orbico SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim artikujsh industrial, import dhe eksport me shumicë dhe pakicë, etj.

Shitësi: ABG-CHAMPION ACQUIRECO S.R.L., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit italian, e cila kryen aktivitetin e shoqërisë mëmë ABG-CHAMPION HOLDCO. ABG, nëpërmjet markës “Champion”, është lider në projektimin, marketingun dhe shpërndarjen e veshjeve e aksesorëve atletikë.

Garantuesi: Authentic Brands Group LLC, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Delaware.

Shoqëria Target: HBI ITALY ACQUISITION CO. S.R.L. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian, e cila kryen aktivitetin e shoqërisë mëmë ABG-CHAMPION ACQUIRECO S.R.L., aktivitetet e shoqërive mbajtëse. Shoqëria target, nëpërmjet Champion Europe, prodhon dhe shet veshje atletike “Champion”, me shumicë si dhe pakicë, drejtpërdrejtë te konsumatorët përmes dyqaneve të zotëruara nga ai vetë.

Pjesë e transaksioni janë edhe filialet që zotëron shoqëria target:

Filialin 1: CHAMPION EUROPE SOCIETA’ A RESPONSABILITA’ LIMITATA, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti: Shitje me shumicë e veshjeve dhe këpucëve, etj.

Filialin 2: CHAMPION PRODUCTS EUROPE LIMITED, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës, me objekt aktiviteti: Komercializimin e mallrave sportive që mbajnë markën “Champion”, përmes kanaleve të shitjes me shumicë dhe pakicë, të distributorëve të licensuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlanë, Francë dhe Beneluks, Europën veriore dhe Lindjen e Mesme, si dhe menaxhimin, zhvillimin dhe kontrollin e gjithë aktivitetit të licensimit të grupit Champion.

Filialin 3: Champion Deutschland GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Prodhim, marketing, shitje dhe shpërndarje e mallrave të konsumit dhe mallrave të markës, etj.

Filialin 4: GAME 7 ATHLETICS SOCIETA’ A RESPONSABILITA’ LIMITATA, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti: Shitje me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të posaçme.

Filialin 5: UNIVERSO SPORT IMMOBILIARE S.R.L., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti: Blerja dhe shitja e pasurive të

paluajtshme dhe dhënie me qira dhe operim i pasurive të paluajtshme vetjake ose të dhëna me qira. Shoqëria target, HBI ITALY ACQUISITION CO. S.R.L., nuk ka prezencë ligjore dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Transaksioni

Ndërmjet shoqërisë ORBICO d.o.o. (blerësi) dhe shoqërisë ABG-CHAMPION ACQUIRECO S.R.L. si (shitësi), dhe Authentic Brands Group LLC si (garantuesi) është lidhur “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, e cila u nënshkrua më datë [.....].

Referuar kësaj Marrëveshje, shitësi do të shesë dhe do të garantojë që aksionet e blera t’i dorëzohen blerësit, pa asnjë barrë (përveç kufizimeve në transferim, sipas ligjeve në fuqi të shteteve federale ose ligjet e huaja për titujt), ndërsa blerësi pranon të blejë nga shitësi, aksionet e shitura.

Finalizimi fillestar i transaksioneve të parashikuara, siç është përcaktuar në “Marrëveshjen për Blerjen e Aseteve” të datës [.....], është realizuar me [.....]. Blerësi do të nënshkruajë edhe një Marrëveshje Licence me Shitësin për të operuar biznesin e shoqërisë target nën markën CHAMPION.

Transaksioni synon blerjen nga shoqëria ORBICO d.o.o. të 100% të aksioneve të shoqërisë target, duke përfutur kontrollin e vetëm mbi shoqërinë HBI ITALY ACQUISITION CO. S.R.L. dhe filialet e saj.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë HBI ITALY ACQUISITION CO. S.R.L nga shoqëria ORBICO d.o.o., i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i tregtimit të veshjeve sportive dhe aksesoreve të tyre. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë HBI ITALY ACQUISITION CO. S.R.L. nga shoqëria ORBICO d.o.o.

ORBICO d.o.o. është një shoqëri aktive kryesisht në shitjen dhe distribucionin e produkteve kozmetike, ushqimore dhe jo ushqimore, farmaceutike, tekstile, etj. dhe është prezente në Shqipëri nëpërmjet ORBICO SHPK.

ORBICO SHPK operon kryesisht në tregun e produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) dhe tregun e bukurisë në vend, por pjesa që zë Orbico SHPK në totalin e tregut të produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) është rreth X%. ORBICO SHPK ofron tregtimin e më shumë se 60 marka si: Puig,

Estee Lauder, Coty Luxury, Shiseido, Clarins, LVMH Brands (Dior), Kellogg, Dalli (Bonux), Varta, Ekaterina (Lipton hot tea), etj.

HBI ITALY ACQUISITION CO. S.R.L. është një shoqëri holding e themeluar sipas ligjeve të Italisë, e angazhuar në blerjen, transferimin dhe mbajtjen e aksioneve. Nëpërmjet Champion Evropë shoqëria vepron si një nga liderët në projektimin, marketingun dhe shpërndarjen e veshjeve dhe aksesoreve atletikë.

HBI ITALY ACQUISITION CO. S.R.L. dhe filialet e saj nuk janë prezentë dhe nuk gjenerojnë të ardhura në Shqipëri.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar konstatohet se, përfundimi i kontrollit të shoqërisë target dhe filialeve të saj nga shoqëria ORBICO d.o.o. mund të ndihmojë që marka Champion të zgjerohet prezencën dhe njohjen e saj nëpërmjet kanaleve të tregimit të blerësit në vendet ku shoqëria target nuk operon sot (Shqipëri). Rrjeti i shpërndarës së blerësit mund të ulë kostot e përgjithshme, duke bërë që produktet e modës më cilësi të lartë të jenë të përballueshme, duke ju ofruar konsumatorëve një përzgjedhje më të gjerë të produkteve me çmime konkurruese.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë HBI ACQUISITION CO. S.R.L. nga shoqëria ORBICO d.o.o..
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1152, Datë 23. 01. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE TË GRUPIT ASIA PULP & PAPER NGA Z. JACKSON WIJAYA LIMANTARA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23. 01. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të vetëm të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara.”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të vetëm të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara.

Referuar katër dokumenteve “Akte Dhurimi”, të nënshkruara më datë 09 gusht 2024, palët në marrëveshje janë:

Pala përfituese: Z. Jackson Wijaya Limantara shtetas i huaj, i cili kontrollon plotësisht Shoqëritë e Grupit Paper Excellence.

Grupi Paper Excellence është një prodhues i larmishëm i llojeve të ndryshme të celulozës së drurit dhe produkteve të përpunuara të letrës. Duke konsumuar vetëm një pjesë të prodhimit të saj të

celulozës për prodhimin e brendshëm të produkteve të letrës, ai shet si celulozën ashtu edhe produktet e saj të letrës në tregun ndërkombëtar.

Grupi Paper Excellence nuk ka seli të regjistruara në Shqipëri, por realizon të ardhura.

Pala dhuruese: Z. Oei Tjie Goan, shtetas i huaj, i cili është aktualisht pronari përfitues fundor i Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper.

Target: Shoqëritë e Grupit Asia Pulp & Paper

Grupi Asia Pulp & Paper është një prodhues i larmishëm i celulozës së drurit dhe produkteve përfundimtare të letrës. Ai zotëron impiante prodhimi në Indonezi dhe Kinë. Asia Pulp & Paper shet produktet e saj të celulozës dhe letrës në mbarë botën.

Shoqëritë holding të cilat kontrollojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi të gjitha shoqëritë e grupit Asia Pulp & Paper janë: *Scotsdale Holding Limited*, *Austin Premium Group Ltd*, *CAPITAL HOLDING STRATEGIC LIMITED* dhe *GLOBAL CAPITAL UNIVERSAL LIMITED*.

Target nuk ka seli të regjistruara në Shqipëri, por realizon të ardhura.

II. Transaksioni

[.....], pala përfituese Z. Jackson Wijaya Limantara dhe pala dhuruese Z. Oei Tjie Goan kanë lidhur katër “Akte Dhurimi”, në lidhje me shoqëritë Scotsdale Holding Limited, Austin Premium Group Ltd, CAPITAL HOLDING STRATEGIC LIMITED dhe GLOBAL CAPITAL UNIVERSAL LIMITED.

Referuar këtyre marrëveshjeve, Z. Jackson Wijaya Limantara do të përfitojë të gjithë kapitalin aksionar me të drejtë vote të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga babai i tij, Oei Tjie Goan. Pas implementimit të transaksionit të propozuar, Z. Jackson Wijaya do të ushtrojë kontrollin e vetëm mbi Shoqëritë e Grupit Asia Pulp & Paper.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për furnizimin (i) celulozës së drurit dhe (ii) produkteve të letrës, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara.

Z. Jackson Wijaya Limantara është zotërues i vetëm i aksioneve të shoqërive holding të Grupit Paper Excellence (Grupi PE). Grupi PE është një prodhues i llojeve të ndryshme të celulozës së drurit dhe produkteve të përpunuara të letrës.

Grupi Asia Pulp & Paper është aktiv në prodhimin dhe furnizimin e llojeve të ndryshme të celulozës së drurit dhe produkteve përfundimtare të letrës.

Në Shqipëri, gjatë vitit 2023, Grupi Paper Excellence ka realizuar të ardhura nga shitja e celulozës, ndërsa Grupi Asia Pulp & Paper ka realizuar të ardhura nga shitja e produkteve të letrës.

Nga sa më sipër, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të vetëm të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Wijaya Limantara.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1154, Datë 29. 01. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË STEFANI & CO SHA NGA SHOQËRIA EUROLAB INTERNACIONAL GRUP SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 01. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA nga shoqëria Eurolab Internacional Grup SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i plotë i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA nga shoqëria Eurolab Internacional Grup SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA nga shoqëria Eurolab Internacional Grup SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë shitje blerje aksione” të nënshkruar më datë [.....], palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Eurolab Internacional Grup SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i aktivitetit të shoqërisë përfshin operacione dhe transaksione të çdo lloji lidhur me importin, eksportin, tranzitim dhe tregtimin e mallrave të ndryshme industriale dhe ushqimore të gatshme, gjysmë të gatshme apo si lëndë të parë, pajisje e makineri e pjesë këmbimi, karburant. e lubrifikante me pakicë e shumicë; veprimtari në fushën e peshkimit dhe të akuakulturës. Rritja e peshkut, zënia, tregtimi dhe i prodhimeve të tjera të detit; veprimtari në shitblerje, marrje ose dhënie me qira të pasurive të paluajtshme, të luajtshme, troje etj; veprimtari në fushën e transportit të mallrave dhe udhëtarëve për llogari të shoqërisë dhe të të tretëve në Shqipëri dhe jashtë saj, dhënie konsulence teknike në fusha të ndryshme që kanë lidhje me objektin e shoqërisë; veprimtari të përfaqësimit të personave fizikë apo juridikë, publike ose private, vendas e të huaj blerje, shitje, eksport dhe import të produkteve të duhanit dhe marketing e tregtim të pajisjeve dhe materialeve, aktivitete marketingu, reklamimi dhe shitjeje etj.

Shoqëria tregon produkte të markave ushqimore të njohura ndërkombëtare, duke përfshirë birrën dhe pije alkoolike të markave Peroni, Kozel, Dom Pérignon, Krug, Campari etj.

Eurolab Internacional Grup SHPK zotërohet 100% nga ortaku i vetëm Z. Dritan Bellaj.

Z. Dritan Bellaj, direkt dhe nëpërmjet shoqërisë Eurolab Internacional Grup SHPK, zotëron X% të kuotave në shoqëritë:

- **Euro Investment Group SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti sipërmarrje në koncesione në fushën e ndërtimit, rrugore, hekurudhore, hidraulike, elektrike, elektronike, të ngrohjes, të kondicionimit, hidrosanitare, të dekoracionit në përgjithësi, kanalizime dhe të gjitha punët e detajuara të lidhura me ndërtimin; shërbime në sektorë imobiliare, shërbime në ndërmarrje, ente publike e private, të tretë në përgjithësi në sektorin tekniko-prodhues; import-eksport dhe tregtim i mallrave të ndryshme ku përfshihen mallrat ushqimore, mallra industrial, si dhe materiale ndërtimi, pllaka, pajisje hidrosanitare, pajisje elektronike e elektroshtëpiake, pjesë këmbimi makinash, mjete kancelarie; tregtimin e biletave gërvishtëse të lojërave të fatit, të biletave dhe kartave të ndryshme telefonike, elektronike apo produkte të gatshme; hapja dhe drejtimi i Agjencive Doganore në të gjithë territorin e Shqipërisë për kryerjen e çdo praktike doganore, pasi të jetë pajisur paraprakisht me lejet e nevojshme të lëshuara nga organet kompetente etj.
- **JONICA COSTRUZIONI SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti kryerjen e investimeve në të gjitha fushat dhe veçanërisht në fushën e ndërtimeve, shitblerje pronash të paluajtshme, eksport, import dhe tregtim të materialeve hidrosanitare, dyer, dritare, materiale elektrike dhe çdo materiali dhe pajisjeje tjetër që bën të mundur plotësimin e ndërtimeve me pjesët përbërëse, si dhe çdo aktivitet tjetër që mund të ushtrohet nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Palët Shitëse:

Zj. Evgjëni Pinguli, shtetase shqiptare, e cila zotëron X% të aksioneve të shoqërisë target.

Zj. Elona Pinguli, shtetase shqiptare, e cila zotëron X% të aksioneve të shoqërisë target.

Zj. Entela Pinguli, shtetase shqiptare, e cila zotëron X% të aksioneve të shoqërisë target.

Zj. Flora Pinguli, shtetase shqiptare, e cila zotëron X% të aksioneve të shoqërisë target.

Z. Kujtim Këllëzi, shtetas shqiptar, i cili zotëron X% të aksioneve të shoqërisë target.

Z. Mihal Panteqi, shtetas shqiptar, i cili zotëron X% të aksioneve të shoqërisë target.

Z. Stefan Pinguli, shtetas shqiptar, i cili zotëron X% të aksioneve të shoqërisë target.

Zj. Evgjëni Pinguli, Zj. Elona Pinguli, Zj. Entela Pinguli, Z. Kujtim Këllëzi, Z. Mihal Panteqi dhe Z. Stefan Pinguli janë aksionarë secili me X%, X%, X%, X%, X% dhe X% të aksioneve në shoqërinë “.. te Birra Stela SHPK”.

.. te Birra Stela SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti resort, bar restorant, ambiente pushimi dhe argëtimi, organizim eventesh etj; SPA, trajtimi të lëkurës dhe trupit, masazhe, shërbime dermo-kozmetike dhe estetike, fitness, mirëmbajtje trupore, pishina, sauna, banjo turke, tregtim artikuj kozmetikë; qendër sportive (pishinë, qendër estetike dhe fizioterapie), akademi noti, organizim i garave të notit etj; hoteleri - turizëm, agjenci turistike, operator turistik, udhëtime brenda dhe jashtë vendit; menaxhimi dhe funksionimi i qendrës së rekreacionit.

Shoqëria Target: STEFANI & CO SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti prodhimit e tregtimit me shumicë e pakicë të artikullit të birrës e pijeve alkoolike e joalkoolike, ujit mineral natyral dhe ujit natyral me gaz karbonik të shtuar; import-eksport, tregtim të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor; Bar-Bufe, restorant, hoteleri; veprimtari të ndryshme në fushën e botimeve, reklamës dhe shërbimit të komisionerisë; ndërtime civile, ekonomike, projektim, zbatim, ndërtim rruge, ujësjellës, kanalizime.

Target nuk zotëron pjesëmarrje në ndonjë shoqëri aktive në tregjet e prekura, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

STEFANI & CO SHA aktualisht zotërohet nga shitësit sipas aksioneve të tyre respektive.

II. Transaksioni

Më datë [.....], ndërmjet shoqërisë Eurolab Internacional Grup SHPK në cilësinë e blerësit dhe Zj. Evgjëni Pinguli, Zj. Elona Pinguli, Zj. Entela Pinguli, Zj. Flora Pinguli, Z. Kujtim Këllëzi, Z. Mihal Panteqi dhe Z. Stefan Pinguli, në cilësinë e shitësve, është nënshkruar “Kontratë shitje blerje aksione”.

Referuar kësaj marrëveshje, shitësit shesin dhe blerësi blen aksionet, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Aksionet shiten nga shitësi të lira nga barrët dhe së bashku me të gjitha të drejtat e këtyre aksioneve, në momentin e Kalimit (përfshirë të drejtën për të marrë dividendët apo shpërndarjet e shpallura, të bëra apo për tu paguar pas kalimit).

Shitësit marrin përsipër që në momentin apo përpara Kalimit, të marrin në mënyrë të rregullt Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e Kalimit dhe të heqin dorë në mënyrë të pakthyeshme nga e drejta e parablerjes mbi aksionet.

Palët kanë rënë dakord që përfundimi i transaksionit dhe transferimi i aksioneve në favor të blerësit kushtëzohet nga marrja e miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës.

Shitësit deklarojnë dhe garantojnë se shoqëria është pronare e markave: *Craft Beer Iliria*, *Birrë Stela* dhe *Birra Stela*. Shitësit heqin dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo lloj pretendimi në lidhje me markat tregtare të regjistruara në emër të shoqërisë dhe se nuk do të kundërshtojnë as tani e as në të ardhmen, përdorimin dhe vlefshmërinë e markave ekzistuese apo çdo lloj versioni / aplikim të ri kombëtar ose ndërkombëtar për markë tregtare, e cila ka ose mund të ketë në përbërje emrin / shenjën “Stela” apo çdo emërtim tjetër të ngjashëm me të.

Në përfundim të transaksionit, Eurolab Internacional Grup SHPK do të zotërojë plotësisht shoqërinë target STEFANI & CO SHA.

Për sa më sipër dhe referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Pala blerëse, shoqëria Eurolab Internacional Grup SHPK ushtron aktivitet në importin, eksportin, tranzitimin dhe tregtimin e mallrave të ndryshme industriale, shitjen, distribucionin direkt, marketingun dhe furnizimin e klientëve me produkte ushqimore të gatshme dhe pije alkoolike. Në tregun e birrës, Eurolab ka importuar dhe tregon birrë të markave të huaja si Peroni, Corona, Asahi, Pilsner Urquell, Grolsch

Shoqëria Target, STEFANI & CO SHA ushtron aktivitetin në prodhimin e tregtimin me shumicë e pakicë të artikullit të birrës e pijeve alkoolike e joalkoolike, ujit mineral natyral dhe ujit natyral me gaz karbonik të shtuar etj. Pjesa më e madhe e të ardhurave realizohet nga shitja e birrës. Markat tregtare të regjistruara të birrës janë “Craft Beer Iliria” dhe dy marka të “Birra Stela”.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si edhe rasteve të ngjashme të trajtuara nga Komisioni Evropian, treg përkatës i produktit i prekur nga transaksioni, do të

konsiderohet tregu i shitjes së birrës. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Oferta e birrës në vendin tonë përmbushet nga prodhimi vendas, si dhe nga prania e kompanive multinacionale, nëpërmjet importit të markave më të njohura të birrës në nivel global, ku për vitin 2023 importi i birrës përbën X% të ofertës së birrës në treg, me një trend në rritje prej X %.

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) në lidhje me ndërmarrjet që operojnë në tregun e birrës së importuar, konstatohet se gjatë vitit 2022-2023 kanë realizuar import të birrës një numër shumë i madh ndërmarrjesh, por evidentohet një qëndrueshmëri e tregut për tre ndërmarrjet kryesore në treg.

Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut është TABACCO HOLDING GROUP me X% të tregut të birrës së importit, e ndjekur nga ndërmarrja Eurolab Internacional SHPK me X% të tregut dhe ALFA SHA me X% të tregut.

Referuar markave të birrës së importuar evidentohet një numër shumë i madh markash, ku marka më e importuar është birra Peja, e cila zë rreth X% të sasisë së birrës së importit. Kjo markë importohet vetëm nga ndërmarrja TABACCO HOLDING GROUP. E dyta renditet birra Peroni me rreth X% të sasisë dhe disa nga importuesit e kësaj marke janë Eurolab Internacional SHPK, Denis SHPK, Gjoka SHPK, Conad Albania, Spar etj. Marka e tretë më e importuar është birra Heineken me rreth 10% të tregut, e cila importohet nga Alfa SHA, Ashel Group, Conad Albania, Gjoka etj.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të dosjes rezultoi se shoqëria Eurolab Internacional SHPK ka importuar një shumëllojshmëri markash, në paketime të ndryshme.

Referuar të dhënave të DPD në lidhje me sasinë e birrës së prodhuar në vend, u konstatua se prodhuesi më i madh i birrës në vend është ndërmarrja ALFA SHA, e cila është një nga ndërmarrjet më të mëdha edhe në tregun e birrës së importuar, me rreth X% të prodhimit vendas për vitin 2023 (me trend rritës krahasuar me vitin paraardhës), e ndjekur nga Birra Korça me rreth X% të tregut. Ndërmarrja STEFANI & CO SHA ka zotëruar në vitin 2023 rreth X% të tregut, me një trend në ulje.

Mbështetur në të dhënat e importit dhe prodhimit të birrës, u vlerësua se tregu i shitjes me shumicë të birrës ka karakteristikat e një tregu mesatarisht të përqendruar drejt kufirit të sipërm të tij. Referuar treguesit CR3 dhe CR5, konstatohet se tregu është i përqendruar në një numër të kufizuar ndërmarrjesh të cilët kanë paraqitur qëndrueshmëri të pjesës së tregut në renditje dhe në dinamikë.

Ndërmarrja kryesore në treg është ALFA SHA, një prodhues i birrës Elbar dhe importues i markave Heineken, Amstel dhe Moreti. Ndërmarrja e dytë paraqitet TABACCO HOLDING GROUP me rreth 19% të tregut me birrën e markës Peja. Pala blerëse, ndërmarrja Eurolab Internacional SHPK, renditet e treta në strukturën e tregut të shitjes së birrës me rreth X% të tregut në vitin 2023 dhe me trend në [...] krahasuar me vitin 2022. STEFANI & CO, shoqëria target në transaksionin e njoftuar,

tregton birrën në markën Stela dhe renditet e pesta, me një pjesë tregu X %. Ndërmarrja paraqet një trend në [.....] të pjesës së tregut dhe sasisë së birrës Stela.

Transaksioni i njoftuar është klasifikuar si përqendrim horizontal me efekte në tregun e shitjes me shumicë të birrës.

Mbështetur në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, u vlerësuan efektet e pakoordinuara dhe të koordinuara që mund të ndikojnë në konkurrencën në treg.

Faktorët, të cilët mund të ndikojnë në krijimin e efekteve të pakoordinuara si pasojë e një përqendrimi, janë: zotërimi i një pjese të madhe të tregut nga ndërmarrjet pjesëmarrëse, ndërmarrjet pjesëmarrëse janë konkurrentë të afërt, klientët kanë mundësi të kufizuara për të ndërruar ofruesin, konkurrentët nuk mund të rrisin ofertën nëse rrisin çmimin, njësia e përqendruar prirët të pengojë zgjerimin e konkurrentëve dhe eliminimi i një force të rëndësishme të konkurrencës.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar u konstatua se transaksioni i përfimit të kontrollit mbi shoqërinë STEFANI & CO SHA nuk do të ketë efekte antikonkurruese të pakoordinuara në tregun e shitjes së birrës për shkak se:

- a) Autoriteti mund të mos identifikojë probleme që lidhen me konkurrencën në nivel horizontal, në ato përqendrim ku indeksi HHI pas përqendrimit është në nivelet ndërmjet 1000 dhe 2000 dhe një delta nën 250, ose me një përqendrim ku indeksi HHI pas përqendrimit është mbi 2000 dhe një delta nën 150.

Indekset e përqendrimit të tregut pas transaksionit pasqyrojnë tregues të moderuar të ndryshimeve në strukturën e tij, pasi Delta HHI është në vlerën 117 për vitin 2023.

Indikatorët e përqendrimit të tregut tregojnë se tregu nuk paraqet shqetësime për konkurrencën për shkak të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të palëve në transaksion.

- b) Produktet e ofruara nga palët në transaksion janë plotësisht të zëvendësueshëm dhe fuqia kundërvepruese e blerësve është e lartë për shkak të shumëllojshmërisë së markave. Pala blerëse dhe shoqëria target janë konkurrentë në treg, por kanë karakteristika të ndryshme të zhvillimit të biznesit.
- c) Shoqëria STEFANI & CO SHA nuk është një konkurrent eficient sipas treguesve ekonomik, ndërkohë që Eurolab Internacional Grup SHPK është një konkurrent me mundësi investimi dhe zhvillimi.

Për këto arsye, gjykohet se transaksioni nuk të do të ketë efekte antikonkurruese të pakoordinuara në tregun e shitjes së birrës.

Tregu i birrës karakterizohet nga një numër i madh ndërmarrjesh dhe një numër i konsiderueshëm markash tregtare. Gjatë analizës u konstatua një stabilitet i pjesëve të tregut dhe renditjes së ndërmarrjeve kryesore në treg, por vetëm njëra prej tyre, TABBACO HOLDING SHPK ka ekskluzivitetin e shitjes së një marke të caktuar (birra Peja). Markat e tjera kanë disa ofertues

(ndërmarrje tregtare). Gjithashtu u konstatua se disa nga ndërmarrjet importuese operojnë në tregun e shitjes me pakicë të produkteve ushqimore, duke u integruar vertikalisht në tregtimin e birrës.

Tregu i shitjes së birrës nuk ka ngritur me parë shqetësime për konkurrencës, për ndonjë shkelje të nenit 4 apo 9 të ligjit, ndaj nuk pritet që transaksioni i njoftuar të ketë ndonjë efekt të mundshëm koordinimi për momentin.

Përqendrimi do të krijojë mbivendosje të aktivitetit të palëve në nivel kombëtar, por pa shfaqur shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA nga shoqëria Eurolab Internacional Grup SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1155, Datë 29. 01. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM INDIREKT NGA SHOQËRIA DR. ING.H.C.F. PORCHE AKTIENGESELLSCHAFT MBI BIZNESIN DHE ASETET QË PËRFSHIJNË BIZNESET *FRANCHISED* TË TREGTIMIT TË MOTORËVE TË DREJTUARA NGA STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 01. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset *franchised* të tregtimit të motorëve të drejtura nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset *franchised* të tregtimit të motorëve të drejtura nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë

bizneset *franchised* të tregimit të motorëve të drejtuar nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD.

Referuar dokumentit “Marrëveshja për shitjen dhe blerjen e biznesit të shitjes së motorëve në ekskluzivitetin e Porsche, të ushtruar nga Stratstone Specialist Cars Limited dhe të njohur si Porsche Center East London dhe Porsche Center South London”, të nënshkruar më datë [.....], palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: PORSCHE RETAIL GROUP LIMITED është një filial në pronësi të plotë të PORSCHE CARS GREAT BRITAIN LIMITED, zotërues i pesë qendrave të shitjes me pakicë të makinave Porsche.

PORSCHE CARS GREAT BRITAIN LIMITED është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar, importuesi i vetëm i makinave motorike Porsche dhe pjesëve rezervë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë me përgjegjësi për shpërndarjen, marketingun dhe mbështetjen e shitjeve.

PORSCHE CARS GREAT BRITAIN LIMITED është një filial në pronësi të Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, kompania mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: dhënie e qerasë financiare dhe shërbimin e sigurimeve të lidhura me shitjet e automjeteve.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.

Pala shitëse: STRATSTONE SPECIALIST CARS LIMITED është një shoqëri private e kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Anglisë dhe Wellsit.

Pala shitëse e pronës: LANKASTER UK LIMITED është një shoqëri private e kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Anglisë dhe Wellsit.

Target: Biznesi dhe asetet e Porsche Center East London dhe Porsche Center South London.

Biznesi i Porsche Center East London (PC East London) është biznesi *franchised* i shitjes, riparimit dhe servisimi i automjeteve të reja dhe të përdorura Porsche dhe shitja dhe furnizimi i produkteve dhe shërbimeve ndihmëse të kryera nga shitësi ose çdo anëtar i grupit të shitësve në pronën e Londrës Lindore dhe pronën e Valor Park nën emrin e Porsche Center East London.

Biznesi i Porsche Center South London (PC South London) është biznesi *franchised* i shitjes, riparimit dhe servisimi i automjeteve të reja dhe të përdorura Porsche dhe shitja dhe furnizimi i produkteve dhe shërbimeve ndihmëse të kryera nga shitësi ose çdo anëtar i grupit të shitësve në pronën e Londrës Jugore nën emrin e Porsche Center South London.

PC East London dhe PC South London janë aktualisht qendra të pavarura të shitjeve të Porsche.

Bizneset target aktualisht janë pjesë e shitësit, STRATSTONE SPECIALIST CARS LIMITED.

Target nuk është i pranishëm në Shqipëri dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në tregun shqiptar për vitin 2023.

II. Transaksioni

Më datë [.....], pala blerëse PORSCHE RETAIL GROUP LIMITED, pala shitëse STRATSTONE SPECIALIST CARS LIMITED dhe shitësi i pronës LANKASTER UK LIMITED kanë nënshkruar “Marrëveshja për shitjen dhe blerjen e biznesit të shitjes së motorëve në ekskluzivitetin e Porsche, të ushtruar nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LIMITED dhe të njohur si Porsche Center East London dhe Porsche Center South London”.

Referuar kësaj marrëveshje, Porsche synon që në mënyrë indirekte, nëpërmjet filialit që zotëron plotësisht PORSCHE CARS GREAT BRITAIN LIMITED, të blejë biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset *franchised* të tregtimit të motorëve të drejtuar nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LIMITED, të njohura si Porsche Center East London dhe Porsche Center South London.

Pas implementimit të transaksionit të njoftuar, target do të zotërohet dhe kontrollohet plotësisht vetëm nga Dr. Ing.h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft, indirekt nëpërmjet PORSCHE CARS GREAT BRITAIN LIMITED dhe si zotërues përfundimtar fundor do të jetë Grupi Volkswagen.

Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit”, parashikohet se: “*Objekt i kontrollit mund të jenë një ose më shumë, ose gjithashtu pjesë të ndërmarrjeve të cilat përbëjnë njësinë ligjore, ose aseteve të kësaj njësie ose vetëm një pjesë e këtyre aseteve. Përfitim i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu.*”.

Gjithashtu në pikën 15 të këtij Udhëzimi “Kontrolli nëpërmjet mënyrave të tjera” parashikohet se: “*Marrëveshjet franchisig / të ekskluzivitetit normalisht nuk çojnë në kontrollin mbi biznesin franchisee / ekskluziv të francindhënsit / të dhënësit të ekskluzivitetit. Franchin – marrësi / Marrësi i ekskluzivitetit zakonisht shfrytëzon burimet e ndërmarrjes për llogari të tij edhe kur pjesë të rëndësishme të aseteve i takojnë francindhënsit / dhënësit të ekskluzivitetit.*”.

Nga vlerësimi i marrëveshjes së mësipërme konstatohet se Biznesi dhe asetet e Porsche Center East

London dhe Porsche Center South London përbëjnë njësi biznesi me përfaqësim në treg, e cila krijon xhiro dhe në përfundim të transaksionit, këto njësi do të zotërohen plotësisht nga Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft. Biznesi dhe asetet e Porsche Center East London dhe Porsche Center South London janë dy qendra të pavarura të shitjeve të Porsche. Këto njësi biznesi shfrytëzojnë furnizimet e produkteve të cilat i marrin nga Porsche.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset *franchised* të tregtimit të motorëve të drejtuara nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet (i) tregu për shpërndarjen me pakicë të automjeteve të reja dhe automjeteve të përdorura të pasagjerëve (“PC”), (ii) tregu për shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve dhe (iii) tregu për shitjen e pjesëve rezervë të automjeteve OE Porsche, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset *franchised* të tregtimit të motorëve të drejtuara nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD.

PORSCHE RETAIL GROUP LIMITED është një filial në pronësi të plotë të PORSCHE CARS GREAT BRITAIN LTD., zotërues i pesë qendrave të shitjes me pakicë të makinave Porsche.

PORSCHE CARS GREAT BRITAIN LTD. është importues i vetëm i makinave motorike Porsche dhe pjesëve rezervë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë me përgjegjësi për shpërndarjen, marketingun dhe mbështetjen e shitjeve.

Biznesi dhe asetet e Porsche East London dhe Porsche South London janë aktualisht qendra të pavarura të shitjeve (franchise) të Porsche.

Target nuk është i pranishëm dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.

Nga sa më sipër, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset *franchised* të tregtimit të motorëve të drejtuar nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1156, Datë 29. 01. 2025

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NDAJ NDËRMARRJEVE
VODAFONE ALBANIA SHA DHE ONE ALBANIA SHA NË TREGUN ME PAKICË TË
SHËRBIMEVE CELULARE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 01. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapjen e procedurës së hetimit parapak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

1. Nisur nga disa ankesa të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi rritjen e çmimit të paketave me parapagesë nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA, si dhe të ankesave në vijim gjatë viti 2024 për ndërmarrjen One Albania SHA, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, realizoi një monitorim në këtë treg, i cili konsistoi në vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA.
2. Referuar Raportit Vjetor të AKEP të vitit 2023², “Dinamika e pjesëve të tregut të shërbimeve celulare”, edhe gjatë vitit 2023, sipërmarrësi Vodafone Albania SHA, vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile. Konkretisht pjesët e tregut për vitin 2023 për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a., varjojnë me: rreth 47% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card; rreth 51%

² <https://akep.al/wp-content/uploads/2024/07/AKEP-RAPORTI-VJETOR-2023-FINAL.pdf>

të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë; rreth 55% të tregut për thirrjet dalëse; rreth 54% të tregut për volumin e të dhënave (internetit); rreth 56% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband); rreth 56% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.

3. Për ndërmarrjen One Albania, sipas Raportit Vjetor të AKEP të vitit 2023, pjesët e tregut janë: rreth 53% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card; rreth 49% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë; rreth 45% të tregut për thirrjet dalëse; rreth 46% të tregut për volumin e të dhënave (internetit); rreth 44% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband); rreth 44% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.
4. Sipas kontratës së pajtimit të Vodafone Albania SHA “Termat dhe Kushtet e Përgjithshme për shërbimet e telefonisë së levizshme”³, pika 5, germa “e”, parashikohet se: Detyrimet e Pajtimtarit për pagesën e tarifës sipas Kontratës së Pajtimit dhe/apo Listës së tarifave në Aneksin Bashkëlidhur kontratës, do t’i nënshtrohen rregullimeve jo më shumë se një herë në vit. Cdo muaj Prill (muaji i aplikimit të ndryshimit), vlera mujore e planit tarifor si dhe cdo pakete do të rritet me një vlerë të barabartë me normën e Indeksit të Çmimeve të Konsumit (“IÇK”) të publikuar në muajin Janar nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Ky ndryshim do të aplikohet duke filluar nga fatura e muajit Prill e në vijim.
5. Ndërmarrja One Albania, me anë të shkresës së protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 211/1 prot., datë 13.03.2024, ka informuar se ka përditësuar kushtet dhe termat e kontratave për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe celulare, si dhe ka përcaktuar një klauzolë mbi indeksimin e çmimeve të pajtimtarëve sipas Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) të publikuar zyrtarisht nga Instituti i Statistikave (INSTAT).
6. Sa më sipër, kjo pikë e parashikuar në kontratën e pajtimit, i lë konsumatorët në pasiguri dhe paqartësi për çmimet që do të paguajnë dhe duke marrë në mënyrë të padrejtë rrezikun dhe barrën e pasigurisë financiare nga inflacioni, gjë që konsumatorët nuk mund ta parashikojnë dhe nuk arrijnë ta kuptojnë mirë. Gjithashtu sipas lajmit të Ofcom⁴ publikuar në 19 korrik 2024⁵, thuhet se: “...Nga 17 janari 2025, ofruesit e telefonisë celulare, të internetit dhe TV me pagesë do t’u

³ <https://www.vodafone.al/vfal-rell/personale/suport/kushte-dhe-afate/informacion-i-prgjithshme-ligjor/termat-e-prgjithshme-pr-pajtimtarin-me-parapages/>

⁴ Ofcom është rregullatori për industrinë e komunikimeve në Angli, i cili trajton dhe rastet e konkurrencës që lidhen me këtë industri. Ofcom bashkëpunon dhe me Autoritetin e Konkurrencës në Angli (CMA) për raste që lidhen me industrinë e komunikimeve.

⁵ <https://www.ofcom.org.uk/phones-and-broadband/bills-and-charges/ofcom-bans-mid-contract-price-rises-linked-to-inflation/>

ndalohet të përfshijnë kushte të rritjes së çmimeve të lidhura me inflacionin. Ndërmarrjet BT⁶ dhe Vodafone kanë ndryshuar tashmë praktikat e tyre të çmimeve në përgjigje të konsultimit të Ofcom....”

7. Tregu i shërbimeve celulare është një treg sensitiv dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar dhe Autoriteti Konkurrencës ndër vite ka hetuar dhe monitoruar këtë treg.
8. Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit, sjellja e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare mund të sjellë kufizim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 31 dhjetor 2024.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

⁶ BT është një nga ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit dhe rrjeteve në Angli.

VENDIM

Nr. 1157, Datë 05. 02. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SHA NGA SHOQËRIA SIGAL BUSINESS CENTER SHPK.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 02. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA nga shoqëria SIGAL BUSINESS CENTER SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar përfutimit të kontrollit të shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA nga shoqëria SIGAL BUSINESS CENTER SHPK.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA nga shoqëria SIGAL BUSINESS CENTER SHPK..

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerje aksionesh”, nënshkruar më datë [.....], palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: SIGAL BUSINESS CENTER SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar e cila zotërohet 100% nga Z.Avni Ponari.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj investimin e kapitalit dhe të burimeve të tjera financiare, për blerje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe në vazhdim të aktiviteteve të saj, shitja e tyre, dhënia me qera e pasurive; zhvillimi dhe kryerja e aktiviteteve të shërbimeve, kërkimeve, konsulencës, projekteve dhe studimeve të të gjitha llojeve. Import-eksport dhe tregtim të të gjitha llojeve të mallrave, etj. Investime financiare të lejueshme nga ligji dhe të gjitha llojet e veprimtarive të real- estate; agjensi imobiliare, ndërmjetësim & marketing në fushën e sigurimeve; ndërmjetësim financiar, operacione me pasuri të paluajtshme, të luajtshme, tregtare, përfshirë dhënie të garancive, dorëzënie, pengje, hipoteka; transport mallrash dhe udhëtaresh; ofrimi i shërbimeve të Hotelerisë, Bar dhe Restorant.

Sipas të dhënave të QKB dhe Formularit të thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit, Z.Avni Ponari është zotërues i kuotave respektivisht në shoqëritë: AVEL SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit)*; CITYPARK SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit)*; INST. I ING. FINANCIARE PER BANKE & SIG. SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit)*; SIGAL UNIQA INVEST – Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit)*; SIGAL – AD SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit)*; SIGAL RESORT Rëra e Hedhur SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit, por me aktivitet të pezulluar)*; TIRANA Shopping CENTER SHA, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit)*; VALBONA Resort SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit)* dhe SELECT ENERGY SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, *(me pjesëmarrje X% të kapitalit)*.

Shoqëritë e kontrolluara nga z. Avni Ponari operojnë në tregje të ndryshme, si tregu i import – eksportit dhe riparimit të automjeteve, i trajnimeve pasuniversitare, dhënie me qira e ambienteve, bar, restorant dhe hoteleri, si dhe agjenci doganore dhe asnjëra prej tyre nuk operon në tregun e sigurimit të jetës dhe jo-jetës.

Avni Ponari është themelues dhe drejtor i përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria SHA, si edhe Kryetar i Bordit Menaxhues të SIGAL UGA LIFE Kosovë; Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të SIGAL UGA Maqedonia e Veriut; dhe Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të SIGAL UGA LIFE Maqedonia e Veriut.

Pala shitëse: UNIQA Österreich Versicherungen AG është një shoqëri aksionare, e themeluar

sipas legjislacionit austriak, e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës Tregtare të Vjenës. Shoqëria UNIQA Österreich Versicherungen AG është një kompani austriake e sigurimeve, e cila zotërohet 100% nga UNIQA Group.

Shoqëria Target: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila zotërohet aktualisht nga shoqëria UNIQA Österreich Versicherungen me X% të aksioneve dhe nga Z.Avni Ponari me X% të aksioneve.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj sigurimin ndaj dëmeve dhe risigurimet, në përputhje me ligjin “Për veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” si dhe çdo objekt tjetër të lejuar nga legjislacioni dhe që nuk vjen në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve. Shoqëria nuk do të ushtrojë veprimtari në lidhje me sigurimin e jetës.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA është një shoqëri e licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin nr.2, datë 23.06.1999.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA ka pjesëmarrje kontrolluese në shoqëritë:

I.Sipas legjislacionit të Shqipërisë

- SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA, ku SIGAL është aksionere me 99.9% të aksioneve dhe UNIQA Österreich zotëron vetëm 1 aksion. SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA zotëron 51% të të drejtave të votës dhe aksioneve në shoqërinë SIGAL LIFE UNIQA Pension Fund Albania (49% e aksioneve zotërohet nga Z.Avni Ponari).

II.Sipas legjislacionit të Kosovës

- SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA është shoqëri me kapital të përbashkët, ku SIGAL është aksionere me 100% të aksioneve.
- SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA është shoqëri me kapital të përbashkët, ku SIGAL është aksionere me 100% të aksioneve.

III. Sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut

- UNIQA AD Skopje është shoqëri me kapital të përbashkët, tek e cila SIGAL është aksionere me X% të aksioneve.
- UNIQA LIFE AD Skopje është shoqëri, me kapital të përbashkët, ku SIGAL është aksionere me 100% të aksioneve.

Transaksioni

Ndërmjet shoqërisë SIGAL BUSINESS CENTER SHPK (blerësi) dhe shoqërisë UNIQA Österreich Versicherungen AG (shitësi), është lidhur “Marrëveshje për blerje aksionesh”, e cila u nënshkrua më datë [.....].

Referuar kësaj Marrëveshje blerësi dëshiron të blejë dhe të përfitojë nga shitësi, dhe shitësi dëshiron të shesë dhe transferojë te blerësi, Aksionet e Synuara (X% aksione që i përkasin të UNIQA

Osterreich Versicherungen AG + X% aksione që i përkasin Z. Edvin Hoxhaj), në çdo rast në përmbyllje dhe sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshje. Kjo Marrëveshje në nenin 3 “Shitja, Blerja dhe Transferimi i Aksioneve të Synuara, Aksionit të Filialit të Drejtpërdrejtë AL dhe Aksionit të Drejtpërdrejtë MK”, përcakton se: Shitësi shet dhe transferon te Blerësi Aksionet e Synuara, Aksionet e Filialit të Drejtpërdrejtë AL (SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA) dhe Aksionet të Drejtpërdrejta MK (UNIQA AD Skopje).

Detyrimi për të përfunduar shitjen dhe transferimin e Aksioneve të Synuara, Aksionit të Filialit të Drejtpërdrejtë AL dhe Aksionit të Drejtpërdrejtë MK do të kushtëzohen nga plotësimi i kushteve të parashikuara në nenin 6 “Kushtet dhe mbyllja” referuar “Marrëveshjes për blerjen e aksioneve”, si vijon:

- Njoftimi paraqitet pranë Autoritetit të Konkurrencës në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

-Miratimi i pjesëmarrjes së kualifikuar në Shoqëri Sigurimi nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri.

-Aprovimi i blerjes indirekte të pjesëmarrjes së kualifikuar në filalet XK (SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA dhe SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA) nga banka qendrore e Kosovës.

-Miratimi nga Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Republikës të Maqedonisë së Veriut për blerjen e aksioneve indirekte (të kualifikuar, të kombinuar) në Filialin MK A (UNIQA AD Skopje).

-Miratimi nga Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Republikës të Maqedonisë së Veriut për blerjen e aksioneve të kualifikuar indirekte në Filialin MK B (UNIQA LIFE AD Skopje), etj.

Sapo të jenë ndërmarrë të gjitha veprimet e mbylljes në përputhje me Marrëveshjen, Palët do të nënshkruajnë një Memorandum përmbyllës në të cilin palët i konfirmojnë njëra-tjetrës se kushtet e mbylljes janë përmbyllur sipas nenin pikës 6.6 “Veprimet në datën e mbylljes”.

Për sa më sipër, transaksioni i synuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA nga shoqëria SIGAL BUSINESS CENTER SHPK., i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Analiza e konkurrencës

Shoqëria target, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA është një shoqëri që ushtron aktivitetin në tregun e sigurimit të jo-jetës dhe nëpërmjet shoqërisë SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA edhe në tregun e sigurimit të jetës.

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, dhe referuar tregut në të cilin ushtron aktivitetin shoqëria target dhe shoqëritë e kontrolluara prej saj, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i sigurimit (sigurimi i jetës dhe i jo-jetës).

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i sigurimeve funksion në zbatim të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregut të sigurimeve, të titujve, të sipërmarrjeve, të investimeve kolektive dhe të pensioneve private vullnetare në Shqipëri.

Referuar të dhënave të raportit statistikor të AMF-së gjatë vitit 2024, konstatohet se në tregun e sigurimeve ushtruan veprimtarinë e tyre 12 shoqëri sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë, katër prej të cilave ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jetës dhe tetë shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës.

Shoqëria SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA është një nga 8 shoqëritë e sigurimit që ushtron veprimtarinë në tregun e sigurimit të jo-jetës dhe referuar të dhënave të raportit statistikor të AMF për vitin 2024, sipas treguesit të primeve të shkruara bruto, rezulton se shoqëria ka patur një pjesë tregu prej X% gjatë vitit 2023 dhe X% gjatë vitit 2024 (me një rënie në vlerë relative prej X% krahasuar me një vit më parë), duke qenë shoqëria me pjesën më të madhe në tregun e sigurimit të jo-jetës.

Për sa i përket tregut të sigurimit të jetës, sipas të dhënave mbi primet e shkruara bruto për sigurimin e jetës për periudhën 2023-2024 rezulton se pjesa e tregut e shoqërisë SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA gjatë vitit 2023 ka qenë X% me një rënie prej rreth X% në vitin 2024 në X%.

Referuar treguesit të përqendrimit HHI rezulton se tregu i sigurimit të jo-jetës është një treg me përqendrim të moderuar me HHI prej rreth X për vitin 2024, ndërsa tregu i sigurimit të jetës rezulton një treg shumë i përqendruar, me HHI rreth X për vitin 2024, por treguesi HHI ka patur [.....] në vitin 2024, krahasuar me vitin paraardhës.

Referuar objektit të aktivitetit të palëve në transaksion, veprimtaria e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA në tregun e sigurimit është e ndarë nga aktivitetet e ndryshme tregtare që kryen SIGAL BUSINESS CENTER SHPK, pra tregjet përkatëse ku operojnë shoqëritë janë të ndryshme.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat, pasi ndërmarrjet që marrin pjesë në përqendrim nuk kanë as marrëdhënie horizontale (si konkurrentë në të njëjtin treg përkatës) dhe as vertikale (si prodhues edhe klientë). Palët në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.

Fushat e veprimtarisë së palëve pjesëmarrëse në transaksion janë të ndryshme nga njëra – tjetra dhe për këtë arsye ky përqendrim nuk do të ketë ndikim në asnjërin prej tregjeve në të cilin secila nga shoqëritë operon, duke mos sjellë shqetësime për konkurrencën në treg dhe duke mos ndikuar në përjashtimin e konkurrentëve të tjerë nga tregu.

Pas realizimit të transaksionit, shoqëria SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA do të vijojë të ushtrojë veprimtarinë e sigurimit, si para realizimit të përqendrimit. Përderisa numri i ndërmarrjeve që operojnë në tregun përkatës nuk ndryshon dhe produktet e sigurimit i gjejmë përgjithësisht tek të gjitha shoqëritë e sigurimit që operojnë në treg, konsumatori ka mundësi zgjedhje mes produkteve të njëjta tek shoqëria që ofron besueshmërinë, cilësinë apo çmimin më të përshtatshëm për të.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA nga shoqëria SIGAL BUSINESS CENTER SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1158, Datë 05. 02. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË SAUBER HOLDING AG DHE FILIALEVE TË SAJ SAUBER MOTORSPORT AG E SAUBER TECHNOLOGIES AG, NGA SHOQËRITË AUDI AKTIENGESELLSCHAFT DHE QATAR HOLDING LLC”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 02. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Sauber Holding AG dhe filialeve të saj Sauber Motorsport AG dhe Sauber Technologies AG, nga shoqëritë AUDI Aktiengesellschaft dhe Qatar Holding LLC.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Sauber Holding AG dhe filialeve të saj Sauber Motorsport AG dhe Sauber Technologies AG, nga shoqëritë AUDI Aktiengesellschaft dhe Qatar Holding LLC”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Sauber Holding AG dhe filialeve të saj Sauber Motorsport AG dhe Sauber Technologies AG, nga shoqëritë AUDI Aktiengesellschaft dhe Qatar Holding LLC.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Investimi”, të nënshkruar më datë 4 dhjetor 2024 dhe “Draft Final – Marrëveshja e Aksionarëve”, palët në marrëveshje janë:

Pala 1: Qatar Holding LLC është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të shtetit të Katarit, e cila investon ndërkombëtarisht dhe lokalisht në kapital strategjik privat dhe publik. Qatar Holding është në pronësi të plotë të Autoritetit të Investimeve të Katarit.

Autoritetit i Investimeve të Katarit është një fond sovran investimesh, i cili investon në një gamë të gjerë të klasave dhe rajoneve të aseteve, si dhe në partneritet me institucionet kryesore kudo në botë, për të ndërtuar një portofol investimesh globale dhe të larmishme me perspektivën afatgjatë për të dhënë kthime të qëndrueshme. [.....].

Qatar Holding LLC dhe Autoritetit i Investimeve të Katarit nuk kanë asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri, por kanë realizuar të ardhura për vitin 2023.

Pala 2: AUDI Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: zhvillimi, prodhimi dhe shpërndarja e mjeteve motorike si dhe automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, aksesorëve të tyre si dhe të gjitha makinerive, veglave dhe artikujve të tjerë teknikë. AUDI është një filial në pronësi të plotë Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij, *Porsche Leasing SHPK* dhe *Porsche Albania SHPK*.

Target: Sauber Holding AG është një shoqëri holding, e themeluar sipas legjislacionit të Zvicrës. Ai zotëron dy filiale :

1. Sauber Motorsport AG (SMAG), i cili lehtëson angazhimin në Formula 1 të Stake F1 Team Kick Sauber, është aktiv në F1 Esports dhe zhvillon pilotë të rinj në akademinë e saj, dhe;
2. Sauber Technologies AG (STAG), i cili është aktiv në aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit të motorsportit dhe ofron ekspertizë të induktuar nga Formula 1 në inxhinieri, prodhim dhe aerodinamikë për palët e treta. Kjo përfshin printimin 3D dhe testimin e tunelit të erës për një shumëllojshmëri produktesh dhe zgjidhjesh.

Qëllimi kryesor i aktivitetit të Sauber është konkurrimi në Kampionatin Botëror të Formula 1, si konstruktor dhe zhvillues i makinave të garave F1 dhe promovimi i markës së ekipit të garave. Ai gjithashtu përdor pajisjet e tij të zhvillimit, prodhimit dhe testimit për të ofruar shërbime për palë të treta. Target nuk është i pranishëm dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.

II. Transaksioni

Më datë 29 nëntor 2024, pala 1 Qatar Holding LLC (Investitori), pala 2 AUDI Aktiengesellschaft (Aksionari ekzistues) dhe Sauber Holding AG (Shoqëria) kanë nënshkruar “Marrëveshje Investimi”.

Referuar kësaj marrëveshje, Investitori synon të investojë kapital në Grupin Sauber dhe të blejë aksione (X) në Shoqëri [.....].

Bashkëlidhur Marrëveshjes së Investimit, si Shtojca A është parashikuar “Draft Final – Marrëveshja e Aksionarëve”, ndërmjet AUDI Aktiengesellschaft (Aksioneri 1), Qatar Holding LLC (Aksioneri

2) dhe Sauber Holding AG (Shoqëria).

Referuar Marrëveshjes së Investimit të nënshkruar dhe Draftit Final të Marrëveshjes së Aksionarëve, transaksioni i propozuar përbën një ndryshim kontrolli [.....]. Sipas Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 3.2 është përcaktuar se: “Kontrolli i përbashkët mund të ekzistojë edhe kur nuk ka barazi ndërmjet dy ndërmarrjeve mëmë për sa i përket votave ose në përfaqësimin në organet vendimmarrëse. Ky është rasti kur aksionarët në pakicë kanë të drejta shtesë, të cilat u lejojnë atyre të marrin vendime vetoje, të cilat janë thelbësore për sjelljen strategjike tregtare të sipërmarrjes së përbashkët/joint venture. Të drejtat e vetos në vetvete mund të ushtrohen nëpërmjet mjeteve të një kuorumi të caktuar, të kërkuar për vendimet që merren në mbledhjen e aksionareve ose nga bordet e drejtorëve në masën që ndërmarrjet mëmë janë përfaqësuar në këtë bord.”

[.....].

Në përfundim të transaksionit të propozuar, Qatar Holding LLC do të zotërojë X% të shoqërisë target Sauber Holding AG, me pjesën e mbetur që do të vazhdojë të mbahet nga AUDI Aktiengesellschaft.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Sauber Holding AG dhe filialeve të saj Sauber Motorsport AG dhe Sauber Technologies AG, nga shoqëritë AUDI Aktiengesellschaft dhe Qatar Holding LLC, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet (i) tregu për aktivitetet reklamuese / sponsorizuese të sporteve të automobilistikës për eventet e Formula 1 dhe, (ii) tregu për ofrimin e shërbimeve në lidhje me menaxhimin e një ekipi F1, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Sauber Holding AG dhe filialeve të saj Sauber Motorsport AG dhe Sauber Technologies AG, nga shoqëritë AUDI Aktiengesellschaft dhe Qatar Holding LLC.

Qatar Holding LLC është shoqëri globale investimesh, e cila investon në kapital strategjik privat dhe publik, në pronësi të plotë të Autoritetit të Investimeve të Katarit, një fond sovran investimesh.

AUDI është një filial në pronësi të plotë Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen është aktiv në mbarë botën për zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave për transportin e pasagjerëve, makinave komerciale, kamionëve, autobusëve, trajlerave, shasive për autobusë dhe motorë benzine, motoçikleta, duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesore për to. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij, në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë e automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre dhe në tregun e dhënies së qirasë financiare dhe shërbimin e sigurimeve të lidhura me shitjet e automjeteve.

Sauber Holding AG është një shoqëri, e cila ka si aktivitet kryesor konkurrimin në Kampionatin Botëror të Formula 1, si konstruktor dhe zhvillues i makinave të garave F1, dhe promovimi i markës së ekipit të garave. Ai gjithashtu përdor pajisjet e tij të zhvillimit, prodhimit dhe testimit për të ofruar shërbime për palë të treta.

Target nuk është i pranishëm dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.

Nga sa më sipër, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Sauber Holding AG dhe filialeve të saj Sauber Motorsport AG e Sauber Technologies AG, nga shoqëritë AUDI Aktiengesellschaft dhe Qatar Holding LLC.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1159, Datë 13. 02. 2025

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1130, DATË 07.11.2024 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E SIGURIMIT TË JETËS PËR KREDI”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 02. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1130, datë 07.11.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e sigurimit të jetës për kredi”.

Bazë ligjore: Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e sigurimit të jetës për kredi”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraparak për të vlerësuar sjelljen e bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi.
2. Për realizimin e procedurave hetimore bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga bankat e nivelit të dytë si dhe nga shoqëritë e sigurimit për vlerësimin e konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi.
3. Nisur nga volumi i informacionit të kërkuar, disa nga bankat kanë kërkuar shtyrje afati për dërgimin e informacionit si dhe Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar bankave dhe shoqërive të sigurimit duke rikërkuar saktësim apo plotësim informacioni, dhe për këto

arsye koha e mbetur në dispozicion nga momenti i depozitimit të informacionit është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1130, datë 07.11.2024.

4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1130, datë 07.11.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi”, pika “III”, të ndryshohet si vijon:

“III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 3 Mars 2025.”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1160, Datë 13. 02. 2025

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË
NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË
BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE FUNDWAY L.L.C. DHE
TRANSFERIMIN E 40% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË UNLIMITED GAMING
SH.P.K. NGA SHOQËRIA FUNDWAY L.L.C. TEK SHOQËRIA BALFIN – BALKAN
FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 02. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe Fundway L.L.C. dhe transferimin e 40% të aksioneve të shoqërisë Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway L.L.C. tek shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe Fundway L.L.C. dhe transferimi i 40% të aksioneve të shoqërisë Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway L.L.C. tek shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe Fundway L.L.C. dhe transferimi i 40% të aksioneve të shoqërisë Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway L.L.C. tek shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Referuar dokumentit “Marrëveshje e Aksionarëve”, të nënshkruar më datë [.....], palët në marrëveshje janë:

Pala 1: Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: investimin në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), ofrimin e shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softuare etj), në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë etj.

Aksionar i kësaj shoqërie është Z. Samir Mane me 100% të kuotave.

Grupi Balfin është i organizuar në gjashtë segmente strategjike të biznesit:

- Shitje me pakicë – Shitja e mallrave për konsum dhe mallrave elektronikë, shitja e lodrave dhe mallrave të modës.
- Miniera & Energji – Eksplorimi, nxjerrja, prodhimi i mineraleve dhe tregtia dhe furnizimi me energji.
- Pronat e paluajtshme – ndërtimi i pronave të paluajtshme, funksionimi i qendrave tregtare dhe vendpushimet luksoze.
- Shërbime – Mirëmbajtja dhe riparimi i shërbimeve elektronike, komerciale dhe të administrimit të qendrave tregtare dhe komplekseve të banimit.
- Banka – Shërbime bankare për individë.
- Të tjera – Aktivitete investimi, shërbime këshillimi, media, edukim.

Në tregun e jashtëm, Grupi Balfin zotëron në Kosovë paketën kontrolluese të shoqërive: Elektro Service Kosova SH.P.K., Kid Zone Kosova SH.P.K. dhe Neptun Kosova SH.P.K.

Pala 2: Fundway L.L.C. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kosovës, me objekt aktiviteti: ndërmjetësimet e tjera monetare; aktivitete të tjera shërbyese financiare, përveç fondit të sigurimit dhe atij pensional; administrimi i tregjeve financiare; shërbimet e ndërmjetësimit për letra me vlerë dhe kontrata të mallrave; aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për menaxhim; zhvillimi i projekteve të ndërtimit; instalimet elektrike; punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit etj.

Në vitin 2021, Fundway hyri në industrinë e argëtimit familjar me projektin “HyperActive”, një qendër moderne dhe gjithëpërfshirëse për argëtimin familjar.

Fundway L.L.C. ka krijuar një degë të shoqërisë së huaj në Shqipëri, me objekt aktiviteti veprimtari në fushën e ndërtimit, projektim dhe ndërtim i objekteve civile dhe industriale, investimin në projekte zhvillimi zonash urbane, administrimi dhe shfrytëzimi i njësive të gjeneruara nga investimet, administrimi në fushën e hotelërisë, restoranteve dhe bareve etj. Dega e shoqërisë së huaj nuk ka realizuar të ardhura në Shqipëri.

Ndërmarrja e Përbashkët (JV): Ndërmarrja e përbashkët do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin e Kosovës, që do të quhet HyperActive Holding.

HyperActive Holding do të krijohet për të funksionuar si një shoqëri mbajtëse, e cila do të ushtrojë aktivitetin e saj përmes shoqërive të veçanta (shoqëritë e projektit), që do të menaxhojnë investimet në sektorin e argëtimit në vende të ndryshme.

Target: Unlimited Gaming SH.P.K. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kosovës, e cila fokusohet në menaxhimin e parqeve argëtuese dhe ofron një gamë të gjerë të aktiviteteve e lojërave argëtuese duke filluar nga karting, bowling, escape rooms, lasertag, VR-hologate, Sakica, Pikado, shuffleboard. Gjithashtu ajo ofron ambiente për organizimin e festave të ditëlindjeve, si dhe salla për organizimin e takimeve zyrtare.

Unlimited Gaming SH.P.K. zotërohet 100% nga Fundway L.L.C.

Shoqëria target është një nga entitetet operacionale kyçe të HyperActive Holding dhe do të integrohet gradualisht në strukturën e saj.

Unlimited Gaming SH.P.K. nuk ka prezencë ligjore dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

II. Transaksioni

Më datë [...], pala 1, Fundway L.L.C., dhe pala 2, Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, kanë nënshkruar “Marrëveshja e Aksionarëve”.

Referuar kësaj marrëveshje, palët në datën e nënshkrimit, por në çdo rast në kohë përpara projektit të parë do të:

1. Themelojnë bashkërisht një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin e Kosovës, që do të quhet HyperActive Holding, përmes së cilës do të bëjnë investime të përbashkëta në parqe argëtuese (Projekte) në vende të ndryshme. HyperActive Holding do të zotërohet 60% nga Fundway dhe 40% nga Balfin. Shoqëria do të themelojë dhe menaxhojë investimin në një vend të huaj përmes shoqërive përkatëse (Shoqëritë e Projektit).

2. Transferojnë pronësinë e 40% të kapitalit aksionar të Unlimited Gaming SH.P.K. (Shoqëria e Projektit në Kosovë) nga Fundway në Balfin duke ekzekutuar marrëveshjen përkatëse. Pavarësisht nga sa më sipër, në bazë të konfirmimit të autoritetit tatimor të Kosovës për bartjen e humbjeve, palët zotohen të transferojnë interesat e tyre të aksionarëve në Shoqërinë e Projektit në Kosovë tek HyperActive Holding, menjëherë pas plotësimit të këtij kushti.

3. Transferojnë pronësinë e Markës HyperActive nga Fundway tek ndërmarrja e përbashkët, duke përfshirë të drejtat e licencimit, modelin e biznesit dhe njohuritë teknike të lidhura, të cilat do të jenë thelbësore për menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve të argëtimit. Gjithashtu Fundway do të ofrojë mbështetje operacionale për entitetet që menaxhojnë qendrat HyperActive në vende të ndryshme, duke siguruar që këto operacione të ndjekin një model të unifikuar, në përputhje me standardet e grupit.

4. Palët kanë rënë dakord që Balfin t'i japë hua Shoqërisë së Projektit në Kosovë, Unlimited Gaming SH.P.K., një shumë të barabartë me X, në lidhje me të cilën shoqëritë Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK (huadhënësi) dhe Unlimited Gaming SH.P.K. (huamarrësi) kanë nënshkruar më datë [.....] “Marrëveshje Huaje”.

Referuar deklaratës së palëve, krijimi i ndërmarrjes së përbashkët HyperActive Holding, transferimi i 40% të kapitalit aksionar të shoqërisë target dhe financimi përmes huasë prej X Euro, janë hapa të ndërlidhur, që përbëjnë fazat fillestare të një transaksioni me një perspektivë qëndrueshmërie afatgjatë.

Qëllimi përfundimtar i kësaj strukture është konsolidimi i operacioneve të shoqërisë target nën HyperActive Holding, duke krijuar një strukturë të integruar që do të mundësojë zhvillimin dhe zgjerimin e investimeve në sektorin e argëtimit në nivel ndërkombëtar. Akti i Themelimit dhe Statuti i HyperActive Holding, si dhe transferimi i 40% të aksioneve të shoqërisë Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway tek Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, do të realizohen dhe finalizohen pas marrjes së miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe Fundway L.L.C. dhe transferimin e 40% të aksioneve të shoqërisë Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway L.L.C. tek shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet (i) tregu i menaxhimit dhe operimit të qendrave argëtuese dhe (ii) tregu i teknologjive të argëtimit. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një grup i diversifikuar investimesh, i angazhuar kryesisht në shitjen me pakicë, pasuritë e paluajtshme, veprimtarinë minerare dhe shërbimet bankare. Grupi Balfin nuk është aktiv në Shqipëri në tregun e menaxhimit dhe operimit të qendrave argëtuese dhe as në tregun e teknologjive të argëtimit.

Fundway L.L.C. përfshin pronësinë e disa kompanive lider në industri të ndryshme, duke filluar nga sigurimet, argëtimi familjar, ndërtimi dhe teknologjia etj. Fundway është prezent në Shqipëri me projektin “Vlora Marina”, i cili përfshin ndërtimin e apartamenteve luksoze dhe objekteve shumëfunksionale në Vlorë.

Shoqëria Target është aktive në menaxhimin e parqeve argëtuese duke ofruar një gamë të gjerë të aktiviteteve dhe lojrave argëtues në Kosovë.

Referuar deklaratës së palës njoftuese, arsyeja kryesore e transaksioni qëndron në zgjerimin strategjik në industrinë e argëtimit dhe shfrytëzimin e mundësive për të diversifikuar portofolin e saj ekzistues të investimeve. Ky transaksion do të mundësojë shkëmbimin e njohurive ndërmjet Fundway dhe Balfin, duke optimizuar operacionet dhe duke përmirësuar konkurrencën e përgjithshme në tregun e argëtimit. Përmes krijimit të JV, palët synojnë të krijojnë një platformë të fuqishme për zhvillimin e projekteve të reja, duke përmirësuar ofertat për konsumatorët dhe duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm në sektor.

Shoqëria Target dhe HyperActive Holding nuk kanë prezencë ligjore dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Transaksioni i propozuar nuk do të sjellë ndryshime të strukturës së tregut në Shqipëri.

Nga sa më sipër, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për pasojë, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe Fundway L.L.C. dhe transferimin e 40% të aksioneve të shoqërisë Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway L.L.C. tek shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1161, Datë 13. 02. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELTA MED SHPK NGA SHOQËRIA DELTA HOLDING SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 02. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.”,

VËREN SE :

II. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës”, nënshkruar më datë 27 nëntor 2024, palët në transaksion janë:

Pala blerëse: DELTA HOLDING SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e zotëruar nga Ortakët: z. Eduart Curraj dhe z. Dorian Sadiku në masën 50 % të kapitalit secili.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë, përfshin por nuk kufizohet me: a) Themelimi, krijimi dhe administrimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja si dhe pjesëmarrja në to; b) Blerja apo disponimin mbi pjesëmarrjen e kapital në korporata, partneritete apo shoqëri e sindikata me objekte aktiviteti të ndryshme; blerja dhe shitja e aksioneve dhe kuotave apo pjesëmarrje të tjera në sipërmarrje dhe shoqëri, brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni i aplikueshëm; c) Blerja, barrësimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme si dhe titujve; d) Konsulencë në fushën e investimeve të huaja dhe vendase. Shoqëria mund të kryej dhe të realizojë çdo aktivitet që lidhet direkt apo indirekt, është si rrjedhim apo ka të bëjë me aktivitetet e renditura me sipër, si dhe mund të ushtrojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur me sipër, që lejohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Shoqëria DELTA HOLDING SHPK zotëron 100% të shoqërive DELTA PHARMA – AL SHPK, METRO FARMACI SHPK, FARMED ANTIBIOTICS SHPK, BIO DERMA SHPK, SMART TECH SOLUTION SHPK dhe 80% të shoqërisë AVICENA SHPK.

Pala Shitëse: PHARMA ONE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Në fushën e tregtisë ku do të kryejë tregtimin me shumicë dhe pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutikë, lëndëve të para, aksesore, para farmaceutike, tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme si pajisje mjekësore industriale e artikujve të ndryshme, elektrike, mekanike, elektronike, cigare të të gjitha llojeve, industriale, ushqimore, të ndërtimit, të mediave, të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të makinerive, të metaleve ferroke dhe joferroke, të lëndës drusore, të lëndëve të para dhe të përpunuara për procesin e prodhimit, tregtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shitblerjen e tokës, tregtimin e mallrave të gatshëm e gjysmë të gatshëm, etj.

Shoqëria zotërohet nga shoqëritë Evita SHPK me 34% të kapitalit, FARMACOM SHPK me 32.66% dhe Med Lab SHPK me 33.34% të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria Target: Shoqëria DELTA Med SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Tregtim të artikujve farmaceutikë dhe kozmetikë, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji. Distributor dhe shpërndarës i barnave dhe medikamenteve mjekësore. Import, eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të barnave dhe medikamenteve mjekësore, barnave popullore, pajisjeve dhe aparaturave mjekësore, mjeteve dhe materialeve ndihmëse mjekësore. Import, eksport tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm kozmetike. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industriale, elektroshtëpiake, elektrike e elektronike, pajisjeve informatike, artikuj kinkalerie, bizhuteri, suvenire, artikuj mobilerie, prodhim dhe tregtim artikuj duralumini, pajisjeve të kondicionimit dhe ajrimit e aksesoreve të tyre. Import eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të materialeve të ndërtimit, pjesëve të këmbimit për automjete, tregtim me pakicë të karburanteve dhe vajra lubrifikante.

Shoqëria target zotërohet tërësisht nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

III. Transaksioni

Më datë 26 nëntor 2024, ortakët e shoqërisë PHARMA ONE SHPK, shoqëritë Evita SHPK, FARMACON SHPK dhe Med Lab SHPK, vendosën me unanimitet miratimin e shitjes së kuotës 100 % që shoqëria PHARMA ONE SHPK zotëron në shoqërinë target DELTA Med SHPK, tek shoqëria DELTA HOLDING SHPK, sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

Po më datë 26 nëntor 2024, ortakët e shoqërisë DELTA HOLDING SHPK, z. D Sadiku dhe z. E Curraj, vendosën, me unanimitet miratimin e blerjes nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK të shoqërisë DELTA MED SHPK, në masën 100% të kuotave të zotëruara nga ortaku i vetëm i saj, shoqëria PHARMA ONE SHPK, sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

Më datë 27 nëntor 2024, pala shitëse, shoqëria PHARMA ONE SHPK, dhe pala blerëse, shoqëria DELTA HOLDING SHPK, kanë nënshkruar dokumentin “Kontratë për shitjen e kuotës”, me objekt përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen e Kuotës së zotëruar nga Shitësi, e cila përfaqëson 100% të kapitalit bazë të shoqërisë DELTA Med SHPK në favor të Blerësit. Në përfundim të transaksionit, shoqëria target DELTA Med SHPK do të zotërohet tërësisht nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK, me përfitues fundor z. Eduart Curraj dhe z. Dorian Sadiku.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

IV. Analiza e konkurrencës

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar, konstatohet se pala blerëse, DELTA HOLDING SHPK, nuk ka realizuar të ardhura gjatë vitit 2023, por nëpërmjet shoqërive DELTA PHARMA – AL SHPK, AVICENA SHPK, METRO FARMACI SHPK dhe BIO DERMA SHPK, operon në tregun e importit eksportit, tregtimit me shumicë dhe pakicë të barnave dhe medikamenteve mjekësore, barnave popullore, pajisjeve dhe aparaturave mjekësore, mjeteve dhe materialeve ndihmëse mjekësore etj.

Shoqëria Target, DELTA Med SHPK është një shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti tregtim të artikujve farmaceutikë dhe kozmetikë, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji.

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes së barnave dhe produkteve farmaceutike dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Referuar të dhënave të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në lidhje me importet e realizuar në kapitullit 30 të Nomenklaturës së Mallrave në RSH “Produkte farmaceutike”, për vitin 2023-2024, u evidentua se ndërmarrjet importuese kanë importuar një gamë

shumë të gjerë të produkteve farmaceutike duke përfshirë, barna, materiale mjekësorë, suplemente ushqimore, produkte kozmetike për përdorim human dhe për kafshë. Të gjitha këto produkte tregtohen nga të njëjtët subjekte tregtare në të gjitha nivelet e tregtimit, depo primare, sekondare dhe farmaci dhe për efekt analizë u vlerësuan në mënyre jo të diferencuar.

Mbështetur mbi të këto të dhëna, u konstatua një numër i madh ndërmarrjesh, të cilat kanë kryer import të produkteve farmaceutikë në vend; në termat e vlerës së produkteve të importuar, nuk evidentohet ndërmarrje me pozitë dominuese; pala blerëse, nëpërmjet shoqërive të kontrolluar prej saj, DELTA PHARMA – AL dhe AVICENA, zotëron rreth X% të tregut në terma të vlerës së importeve, duke u renditur në një nga importuesit kryesor në treg dhe nëpërmjet shoqërisë METRO FARMACI SHPK, është e integruar në rrjetin e hapur të farmacive, nëpërmjet farmacive Ditë e Natë.

Shoqëria DELTA MED SHPK operon si një depo sekondare, distributor, e fokusuar në tregtimin e produkteve farmaceutike në qytetin e Shkodrës.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim vertikal, pasi pala blerëse, nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj, ushtron aktivitetin në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutikë, si depo primare dhe farmaci, ndërkohë që shoqëria target operon në tregun e shitjes me shumicë, si depo sekondare.

Referuar Udhëzuesit “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, përqendrimet jo-horizontale në përgjithësi, kanë më pak mundësi për të kufizuar ndjeshëm konkurrencën pasi nuk shkaktojnë humbjen e konkurrenteve të ndërmarrjeve pjesëmarrëse që veprojnë në të njëjtin treg përkatës; përqendrimet vertikale dhe konglomerate sigurojnë mundësi reale për eficensa; integrimi mund të çojë në uljen e kostove të transaksionit dhe lejon një koordinim më të mirë për sa i përket marketimit, menaxhimit dhe ruajtjen e cilësisë së produkteve.

Treguesit e përqendrimit të tregut para dhe pas përqendrimit nuk shfaqin shqetësime për konkurrencën, pasi pjesët e tregut të palëve në transaksion janë nën 25% dhe HHI pas përqendrimit është nën 1800.

Sa më sipër, përqendrimi do të krijojë marrëdhënie vertikale midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, por pa shfaqur shenja të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1162, Datë 07. 03. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË AGNA SHA, SEMAN SUNPOWER SHPK DHE ALBANIAN GENERAL ELECTRICITY SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 03. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, Seman Sunpower SHPK dhe Albanian General Electricity SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, Seman Sunpower SHPK dhe Albanian General Electricity SHA,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, Seman Sunpower SHPK dhe Albanian General Electricity SHA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala 1: AGNA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-export të mallrave industriale e ushqimore, materiale ndërtimi, prodhime bujqësore dhe blegtorale, prodhim e shitje pije alkoolike; në fushën e investimit në ndërtim, në fushën e shitblerjes së trojeve për ndërtim, për turizëm, fshatra turistike, moteleri dhe hoteleri; tregtim import - eksport i produkteve dhe nënprodukteve të duhanit; shitblerje, marrje ose dhënie me qera të pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme; veprimtari trajnuese dhe certifikuese të punonjësve të administratës publike, punonjësve të institucioneve arsimore; auditimi, mbikëqyrja dhe certifikimi i zbatimit të standardeve ndërkombëtare për institucionet në përgjithësi dhe/ose personelin e tyre në veçanti etj.

Shoqëria AGNA SHA kontrollohet nga z. Kosta Sotiri, z. Vasil Naçi, z. Kristo Naçi dhe z. Aleksandër Naçi.

Sipas të dhënave të QKB, shoqëria AGNA SHA zotëron kuota respektivisht në shoqëritë: a) HIDROBEGAJ SHPK, HYDROBORSH SHPK dhe ENERGJI GRUP SHPK, shoqëri të cilat operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike, b) The PLAZA Tirana SHPK në tregun e hotelierisë, c) AMB CONSTRUCTION SHPK në tregun e import-eksport të mallrave industriale e ushqimore, ç) Shtëpia e Pritjes SHPK në tregun e ndërtimeve.

Pala 2: Seman Sunpower SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti prodhimin e energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet e energjisë të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e erës, gjeotermale, e biomasës ose biogazit, si dhe energjia nga mbetjet urbane; projektimi, ndërtimi dhe studimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve, të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e burimeve të energjisë që gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si dhe projektimi dhe studimi i Nënstacioneve të Linjave të Transmetimit TU dhe TL; shitja e energjisë elektrike klientëve dhe blerja e energjisë elektrike nga operatorë të ndryshëm privat apo shtetëror brenda dhe jashtë vendit, transmetimi i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar, veprimtaria si operatori i sistemit të transmetimit për të kryer aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike dhe të dispeçerimit (rregullimi i prodhimit) të energjisë elektrike sipas kërkesave të konsumit, në nivel kombëtar, shpërndarjen, transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit, të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit.

Seman Sunpower SHPK zotërohet nga z. Besar Llapashtica dhe nga z. Artan Hajdari.

Shoqëria Seman Sunpower SHPK zotëron kuota respektivisht në shoqëritë SEA SOLAR ENERGY SHPK, REBESOL SHPK, AGE SUNPOWER SHPK, DRIBEN SHPK dhe WINDSBAB SHPK, shoqëri të cilat zbatojnë projekte në fushën e energjisë së rinovueshme.

Pala 3: Albanian General Electricity SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti studime dhe analiza në fushën e energjisë në përgjithësi, projektimi i të gjitha llojeve të veprave energjetike, ndërtimi i hidrocentraleve të të gjitha llojeve e

impianteve të ndryshme energjetike, ndërtimi i linjave të tensionit e interkonjeksionit të të gjitha niveleve të tensionit, menaxhimi dhe operimi i veprave të ndryshme energjetike, operimi optimal tekniko ekonomik i Hidrocentraleve, termocentraleve dhe llojeve të tjera të impianteve të erës, termale, gjeotermale e solare për prodhimin e energjisë elektrike, shitja e energjisë elektrike klientëve e operatorëve të ndryshëm privat apo shtetëror brenda e jashtë vendit, transmetimi i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar; përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjeve, transformuese e kontrolluese për transmetimin e energjisë elektrike, veprimtaria si operatori i sistemit të transmetimit për të kryer aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike dhe të dispeçerimit (rregullimi i prodhimit) të energjisë elektrike sipas kërkesave të konsumit, në nivel kombëtar, shpërndarjen, transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit, të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit, exportin, importin dhe tranzitimin e energjisë elektrike. Veprimtaria e shoqërisë do të kryhet sipas lejeve dhe licencave përkatëse të lëshuara nga Autoritetet e Shtetit Shqiptar.

Albanian General Electricity SHA aktualisht kontrollohet nga z. Besar Llapashtica.

Albanian General Electricity SHA, direkt dhe nëpërmjet aksionarit të saj, zotëron kuota në shoqëritë AGE KUÇ SHPK; ARINNA SHPK; ZENINA SHPK, të cilat janë zbatuese të projekteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, por referuar informacionit të ERE dhe pasqyrave financiare të shoqërive, nuk evidentohen të kenë realizuar prodhim të energjisë për vitin 2023.

Ndërmarrje e Përbashkët (JV): ASSA ENERGY SOLUTIONS SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltai, me një kapacitet minimal të instaluar prej 10 MW, me vendndodhje në Grykë Seman, Fier, në përputhje me kriteret dhe rregullat që rrjedhin nga detyrimet ligjore të përcaktuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji, në përputhje me rregullat dhe dispozitat në fuqi për implementimin e parkut fotovoltai 10 MW. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe / ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës, në funksion të realizimit të projektit për Parkun Fotovoltai 10 MW etj.

II. Transaksioni

Më datë 06.12.2024 palët kanë hartuar dhe nënshkruar statutin e shoqërisë ASSA ENERGY SOLUTIONS SHPK.

Referuar Statutit të shoqërisë ASSA ENERGY SOLUTIONS SHPK, kapitali themeltar i saj përbëhet nga 3 kuota, ku 1 kuotë e shoqërisë Seman Sunpower SHPK përfaqëson 40% të kapitalit, 1 kuotë e shoqërisë AGNA SHA përfaqëson 40% të kapitalit dhe 1 kuotë e shoqërisë Albanian General Electricity SHA përfaqëson 20% të kapitalit.

Organi më i lartë vendimmarrës i ndërmarrjes së përbashkët është Asambleja e Përgjithshme. Ajo merr vendime të cilat kërkojnë $\frac{3}{4}$ e votave në rastet e: a) Ndryshimeve në statut, b) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, c) Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, d) Shpërndarja e fitimeve, e) Raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti. Për rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% të kapitalit. Në rastin kur Asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se $\frac{1}{2}$ e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike.

ASSA ENERGY SOLUTIONS SHPK do të ushtrojë aktivitetin e saj për një kohë të pacaktuar.

Transaksioni i njoftuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, Seman Sunpower SHPK dhe Albanian General Electricity SHA, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëritë palë në marrëveshje, vetë ose nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej tyre, kanë si objekt aktiviteti prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, disa prej tyre janë në fazën e zbatimit të projekteve të ndërtimit të impianteve prodhuese ose janë të pajisura me licencat përkatëse për prodhimin e energjisë elektrike.

Shoqëria e zotëruar nga AGNA SHA, **HYDROBORSH SHPK**, është pajisur me Licencë për prodhimin e energjisë nëpërmjet hidrocentralit në lumin Fterë, Sarandë, (në lidhjen 35 kv) me fuqi të instaluar 1.08MW dhe me një prodhim vjetor gjatë vitit 2023 prej 7987 MWh. Prodhimi i HEC-it lidhet në rrjetin e shpërndarjes dhe pjesa e tregut që zë shoqëria HYDROBORSH ndaj totalit të energjisë se lidhur me këtë rrjet është X% dhe ndaj totalit të tregut të prodhimit të energjisë elektrike është X%.

Shoqëria **Seman Sunpower SHPK** është pajisur me Licencë dhe zotëron një impiant fotovoltaik, i lidhur në rrjetin e shpërndarjes në centralin fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas) 2, me një prodhim prej 3,799MWh. Pjesa e tregut që zë shoqëria Seman Sunpower SHPK në prodhimin nga centralet fotovoltaike është X% dhe ndaj totalit të tregut të prodhimit të energjisë elektrike është X%.

Shoqëria Seman Sunpower zotëron shoqërinë **AGE SUNPOWER SHPK**, e cila operon në një impiant fotovoltaik në Topojë (Sheq Marinas) të lidhur në rrjetin e shpërndarjes. AGE SUNPOWER SHPK ka realizuar prodhim për vitin 2023, prej 3,726 MWh ose X% të tregut të prodhimit të realizuar nga centralet fotovoltaike dhe X% ndaj totalit të tregut të prodhimit të energjisë elektrike.

ASSA ENERGY SOLUTIONS SHPK, do të jetë e fokusuar në ndërtimin dhe operimin e impiantit fotovoltaik me një kapacitet të instaluar 10 MW me vendndodhje në Grykën Seman Fier, sipas afatit të përcaktuar në kontratë. Referuar tabelës së mësipërme, fuqia e instaluar nga impiantet fotovoltaike është 48 MW energji dhe në momentin futjes në shfrytëzim, impianti në Grykën e Semanit do të rrisë me 20% fuqinë e instaluar nga ky burim energjie.

Në totalin e kapacitetit prodhues të energjisë elektrike në vend, fuqia e këtij impianti do të jetë shumë e vogël.

Transaksioni i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, e cila pritet të jetë aktive në tregun e energjisë elektrike (në prodhimin e energjisë), do të sjellë përfitime për konkurrencën pasi do të sjellë hyrjen e një konkurrenti të ri në treg.

Për sa më sipër, përqendrimi do të krijojë mbivendosje midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, por pa shfaqur shqetësime për konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, Seman Sunpower SHPK dhe Albanian General Electricity SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS**

2025

BULETINI ZYRTAR



2025